



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.09.2023

MBLEDHJA Nr. 47,
Datë 11.09.2023, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 11.09.2023, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 47 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 06.09.2023.
2. Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike
3. Mbi miratimin e “Kontratës TIP për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.
4. Mbi licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 1950 KW
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj
6. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “SELCA ENERGJI” shpk për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Selca

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI